



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**V E N D I M
Nr. 233, datë 16.07.2012**

“Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 16.07.2012, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i “Raportit të monitorimit në tregun e prodhimit/Importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”;

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- “Raportit të monitorimit në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1- Autoritetit të Konkurrencës në bazë të informacioneve se në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos dyshohej për një marrëveshje të fshehtë për rritjen e çmimit të çimentos, ka monitoruar tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit çimento.

- 2- Në vijim të procedurës së monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës kërkoi informacion nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, dhe ndërmarrjeve që veprojnë në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.”

II. Përshkrimi i situatës në tregun e çimentos

- 3- Tregu i importit të çimentos për periudhën Janar-Prill 2012 është një treg shumë i përqendruar pasi janë vetëm dy ndërmarrje që importojnë këtë produkt.
- 4- Tregu i prodhimit/shitjeve me shumicë për periudhën Janar – Prill 2012 është shumë i përqendruar. Në këtë treg janë 4 ndërmarrje të cilat prodhojnë/tregtojnë produktin çimento. Ky numër i vogël ofruesish të këtij produkti reflektohet në përqendrimin e lartë të tregut.
- 5- Tregu i çimentos shfaq barriera për hyrje të reja në treg si marrja e lejeve përkatëse minerare për shfrytëzimin e mineraleve ndërtimore të cilët përdoren si lëndë e parë për prodhimin e çimentos, leje mjedisore për instalimet e tyre të cilat mund të ndikojnë në shkarkimet dhe ndotjen etj...
- 6- Nga të dhënat e administruara rezulton se në një periudhë të caktuar të këtij viti, gjysma e dytë e muajit shkurt dhe fillimet e muajit mars, çmimi i shitjes së çimentos ka patur një tendencë rritjeje të fortë dhe drejt një çmimi rreth 60 euro/ton, që tregon që konkurrenca në treg mund të jetë kufizuar.

Sa më lart, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 24, shkronja d si dhe nenin 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

- I. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të çimentos, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.
- II. Periudha objekt hetimi do të jetë nga 01.01.2012 deri në 30.09.2012 përfundimin e procedurave hetimore.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe hartimin dhe paraqitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se 4 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana Konomi

(_____)
Zv/Kryetar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R